



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 09.01.2019	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Alfred Gjoni		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Alfred Gjoni		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar/Kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Kurbin.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor për shqyrtim të mëtejshëm.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën në datën 14.01.2019, ora 12:00.		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjyqësore (emrat)	Kryesues: Etleda Ciftja, Relator: Roland Ilia, Anëtar: Firdes Shuli.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): z. Ferdinando Buaer de Mongeot		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Ardian Visha (Avokat)		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Amilda Celami		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Media (gazetarë, operatorë), përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, qytetarë të interesuar. Numri total i të pranishmëve varioonte 20-25 persona.		
Media e pranishme:	Gazetarë të mediave të ndryshme ishin të pranishëm duke respektuar rregulloren e KPK-së.		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	KPK e bazoi gjykimin mbi dy kriteret (Vlerësimi i pasurisë, Vlerësimi i aftësive profesionale)		
D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
	Raporti i ILDKPKI-së : Deklarim i pasaktë, nuk ka burime të ligjshme financiare, subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, deklarimi rremë, subjekti nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, aftësive profesionale, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e

D1. Pasuria	<p>Në lidhje me kriterin e pasurisë rezultojnë: 1. Ap. Banimi 60m2, fituar me kontratë shitblerje të datës 06.06.2001. Vlera: 1.9 milion. Burimi: kursime nga paga dhe kontribut nga babai dhe i vëllai. KPK ka konstatuar mungesë të ardhurash për blerjen dhe mobilimin e apartamentit. Rezultojnë se z. Gjoni në datën 06.06.2001 ka poseduar vetëm 7.600 lekë. KPK ngriti dyshime se çmimi i blerjes së apartamentit ishte më i ulët se çmimi i tregut. Nuk është deklaruar vlera e mobilimit të shtëpisë. 2. Ap. Banimi 47.7m2, fituar me leje legalizimi të datës 23.04.2013. Vlera: 600 mijë lekë. Burimi: kursime nga paga. KPK ka arritur në përfundimin se shtesa është filluar në vitin 2011 dhe ka mospërputhje me deklaratën e subjektit. Relatori i çështjes citoi mungesë financiare për ndërtimin e saj, nuk është deklaruar shtesa në deklaratën Vetting të vitit 2013.3. Gjendje Cash 500 mijë lekë. 4. Kredi e marrë në vitin 2005. KPK ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen e kredisë deri në vitin 2007. 4. Dhënie huaje personit E.C, të padeklaruar. Për këtë veprim subjekti nuk zotëron dokumentacion provues. KPK ka provuar se z. Gjoni nuk ka pasur të ardhura për të dhënë hua. 5. Ap. Banimi në Durrës, pasuri e padeklaruar. Subjekti ka dhënë deklarata jo të sakta dhe në mospërputhje me njëra tjetrën në lidhje me këtë apartament. 6. 3 automjete në përdorim, të padeklaruar. 7. Udhëtime në datën 05.08.2013 dhe 08.08.2018 në Bruksel, të padeklaruar.</p>	Relatori i çështjes	<p>ardhura nga ILDKPKI, Inspektoriati i KLD, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova.</p>
	<p>Në fjalën e tij avokati theksoi dhe vuri në pah karrierën prej 24 vitesh të z. Gjoni dhe nuk duhet të kishte dyshime dhe se justifikohen të gjitha asetet e tij. Në total e gjithë pasuria e z. Gjoni mund të përmbledhej në një ap. banimi 60m2, shtese në tarracë prej 47.7m2. Banesa është blerë në shumën e cituar në kontratën e shitblerjes dhe se shtesa ishte ndërtuar në vlerë simbolike ndër vite. Duhet të merret në konsideratë se deri në vitin 2001 z. Gjoni ka jetuar së bashku me prindërit e tij. Për të vërtetuar të gjitha këto, pohoi së ishin marrë dy ekspertë, inxhinier dhe ekonomist, për të verifikuar të gjitha dyshimet e ngritura nga KPK në lidhje me pasurinë. Në lidhje me çmimin e apartamentit ishin marrë kontratat e 18 banorëve të pallatit në mënyrë që të verifikohen lehtësisht çmimet e blerjes së apartamenteve. Në lidhje me apartamentin në Durrës, theksoi se ishte përdorur në mirëbesim vetëm për muajt e verës. Apartamentin e zotëron znj.. Toptani. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka në pronësi por në përdorim. Në lidhje me udhëtimet e z. Gjoni pohoi se të gjitha udhëtimet për jashtë vendit i ka zyrtare.</p>	Mbrojtja	
	<p>Në lidhje me ap. banimit prej 60m2, që KPK e ka konsideruar në çmim real 31 milion, pohoi se kishte mundur të merrte kontratat e fqinjëve për të bërë krahasimin dhe për të parë çmimet e zonës. Apartamenti është në kat të 7, pa ashensor. Lidhur me transfertë bankare prej 200 mijë lekësh të vjetra (fakt që u citua nga relatori si dhënie hua), pohoi se nuk kishte dhënë pëlqimin e tij, madje kishte ngritur padi civile ndaj bankës për këtë transfertë pa pëlqimin e tij.</p>	Subjekti	

		Ankesa nga publiku	
		ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar		Të dhëna nga raportet e DSIK	
		Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
		Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Raporti i KLD-së: Organizim jo cilësor i punës, vihen në dyshim aftësitë profesionale të argumentim jo plotë i vendimeve gjyqësore.	Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	
	KPK në hetimin e të thëlluar ka arritur në konkluzion: subjekti ka tejkaluar afatet në disa çështje gjyqësore. Njëra prej çështjeve ka zgjatur mbi 4 vjet dhe për tre çështje të tjera vendimet e dhëna konsiderohen jo cilësore, më anomali në argumentimin e tyre.	Relatori	
	Përfaqësuesi i ONM-së ngriti disa pyetje teorike ndaj subjektit të rivlerësimit. Pyetjet : Përkufizimi i veprës penale? Çfarë është vrasja me dashje dhe vrasja me paramendim? Nga ndryshojnë? z. De Mongeot citoi një rast/kazus në lidhje me termat e mësipërm dhe kërkoi zgjidhjen e tij nga Z. Gjoni.	ONM	
	Subjekti i rivlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale deklaroi se si kryetar gjykate, çështjet i ka gjetur në zvarritje dhe se ka qenë gjyqtar në 5 gjykata të tjera (Lezhë, Krujë, Dibër, Burrel) dhe njëkohësisht kryetar i Gjykatës së Kurbinut, Këtë fakt e cilësoi si absurd të KLD-së. Pohoi se vendimet e dhëna prej tij nuk janë cenuar nga asnjë gjykatë më e lartë. Në lidhje me çështjen e Burrelit, për një vrasje, deklaroi se nuk ka qenë kryesues i trupës por anëtar, dhe se vendimmarrja e tij nuk ka qenë shumë e rëndësishme.	Subjekti	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësuar, kryetar në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Kurbin, zgjati rreth 1 orë, duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë. Pati kontestime, pyetje nga përfaqësuesi i ONM-së, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit dhe mbrojtësi i tij ligjor. Përfaqësuesi i ONM me pyetjet e drejtuara subjektit të rivlerësimit, tregoi dyshime mbi aftësitë profesionale të tij. Pyetjet ishin të natyrës teorike. Në citimin e kazusit lidhur me veprën penale të vrasjes me dashje dhe me paramendim, subjekti i rivlerësuar dha disa herë përgjigje të teju zgjatur, duke hasur këmbënguljen e përfaqësuesit të ONM-së për një përgjigje konkrete. Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan dy kriteret e gjykimit të procesit të rivlerësimit (Vlerësimi i pasurisë dhe aftësive profesionale). Subjekti i rivlerësuar pohoi se ishte njohur dhe kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes dhe i ishte kaluar barra e provës. Relatuesi i trupës së gjykimit në fjalën e tij citoi faktin se ndaj subjektit ishin drejtuar disa ankesa, por pa përmendur numrin e tyre dhe natyrën. Trupi gjykues në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësuar kishte zgjedhur të përfaqësohej me avokat mbrojtës. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantonte respektimin e plotë të standardeve të një seance publike.		